

Strasbourg, 6 dhjetor 2024

## KËSHILLI KONSULTATIV I GJYQTARËVE EUROPIANË (KKGJE)

### Opinion nr. 27 (2024) i KKGJE-së

#### për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve

#### I. Hyrje

1. Në përputhje me termat e referencës të dhëna nga Komiteti i Ministrave, Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Europeanë (KKGJE) ka përgatitur këtë Opinion për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve.
2. Përgjegjësia disiplinore është e lidhur ngushtë me pavarësinë gjyqësore. Nëse përgjegjësia e gjyqtarëve nuk është e rregulluar në mënyrë të qartë dhe mjaftueshëm, atëherë pavarësia gjyqësore është në rrezik. Kjo shfaqet në rrethana ku gjyqtarët mund të përballen me pasoja potencialisht të dëmshme për sigurinë e qëndrimit të tyre në detyrë dhe/ose mundësitë në karrierë në rrethana të paqarta. Përgjegjësia disiplinore është e rëndësishme që gjyqtarët të japin llogari te publiku për shkelje në detyrë. Është një mjet me të cilin shoqëria mund të sigurojë që gjyqësori do të përmbushë siç duhet funksionin e tij, duke forcuar kështu besimin e publikut te gjyqësori.
3. Përgjegjësia e gjyqtarëve është bërë një temë shqetësuese vitet e fundit. Disa vendime të gjykatave europiane kanë gjetur që ekzekutivi ka përdorur masa disiplinore

që gjyqtarët të heshtin ose i ka shkarkuar gjyqtarët të cilët nuk kanë vendosur në favor të tyre.<sup>1</sup> Nisur nga zhvillimet më të fundit, është e nevojshme të reflektohet mbi bazën, justifikimin dhe kufijtë e përgjegjesisë disiplinore të gjyqtarëve.

## II. Qëllimi dhe objekti i Opinionit

4. KKGJE e ka trajtuar tashmë këtë çështje në Opinionin nr. 3 mbi parimet dhe rregullat që rregullojnë sjelljen profesionale të gjyqtarëve, në veçanti etikën, sjelljen e papajtueshme dhe paanshmërinë. Qëllimi i këtij Opinionit është të bëjë një vlerësim të të gjitha zhvillimeve që nga miratimi i Opinionit nr. 3 (2002), të vlerësojë, dhe të zhvillojë standarde për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe të marrë parasysh ndikimin e tyre në pavarësinë gjyqësore. Ai ofron një sërë parimesh bazë dhe rekomandimesh të zbatueshme për të gjitha shtetet anëtare dhe është hartuar për të trajtuar situatat ku mund të rrezikohen pavarësia dhe paanshmëria gjyqësore.
5. Ky Opinion trajton pyetjet e mëposhtme:
  - a. Si përcaktohet zbatimi i duhur i përgjegjesisë disiplinore gjyqësore?
  - b. Cili është kuadri ligjor dhe organizimi i duhur i procedurave disiplinore kundër gjyqtarëve?
  - c. Cilat janë shkaqet e pranueshme për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve?
  - d. Cilat janë garancitë e nevojshme procedurale për gjyqtarët në procedimet disiplinore?
6. Opinionit nuk trajton përgjegjësinë civile ose penale të gjyqtarëve, të cilat janë tema mjaft të gjera më vete.
7. Ndonëse ky Opinion nuk trajton vettingun, KKGJE nuk mund ta anashkalojë këtë çështje në heshtje të plotë. Vetingu nuk duhet të përdoret si zëvendësim për masat disiplinore. Vetingu nuk mund të përdoret as për të adresuar korrupsionin. Megjithatë, KKGJE pranon që vettingu mund të jetë i lejueshëm si një procedurë e jashtëzakonshme që ndodh vetëm një herë në tranzicionin nga një qeveri autoritare në një qeveri demokratike ku sundon ligji.
8. Opinionit është përgatitur në bazë të Opinioneve të mëparshme të KKGJE-së, veçanërisht Opinioneve nr. 3 (2002) dhe nr. 18 (2015), Magna Carta-s të KKGJE për Gjyqtarët (2010) dhe instrumenteve përkatëse të Këshillit të Europës, përfshirë, por jo vetëm Kartën Europiane mbi Statutin e Gjyqtarëve, Raportin e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës të vitit 2023 mbi Gjendjen e Demokracisë, të Drejtave të Njeriut dhe Sundimin e Ligjit në Europë, Rekomandimin e Komitetit të Ministrave CM/Rec(2010)12 mbi Gjyqtarët: Pavarësia, Efikasiteti dhe Përgjegjësitë, Raportin e Komisionit Europian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) mbi Pavarësinë e Sistemit Gjyqësor, Raportin e Vlerësimit të Sistemeve Gjyqësore Europiane: Cikli i Vlerësimit 2024 i Komisionit Europian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), rezultatet e Raundit të Katërt të Vlerësimit të Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO) në lidhje me gjyqtarët, Vlerësimin e Zbatimit të Planit të Veprimit të Këshillit të Europës për Forcimin e Pavarësisë Gjyqësore dhe Paanshmërinë të Komitetit Europian për

---

<sup>1</sup> Cf. Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian (GJDBE), 15.7.2021, C-791/19 - *Komisioni kundër Polonisë* (Régime disciplinaire des juges), ECLI:EU:C:2021:596; GJEDNJ *Grzęda kundër Polonisë* [DHM], 15.3.2022, nr. 43572/18.

Bashkëpunimin Ligjor (CDCJ) dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Gjithashtu merr parasysh Parimet Bazë të OKB-së mbi Pavarësinë e Gjyqësorit, Parimet e Bangalore për Sjelljen Gjyqësore, Raportin e Rrjetit European të Këshillave për Gjyqësorin (ENCJ) mbi Pavarësinë, Llogaridhënien dhe Cilësinë e Gjyqësorit, Rekomandimet e OSBE-së mbi Pavarësinë dhe Llogaridhënien Gjyqësore (Rekomandimet e Varshavës) dhe instrumente të tjera relevante.

9. Opinioni gjithashtu merr parasysh përgjigjet e anëtarëve të KKGJE-së në pyetësonin mbi përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe draftin paraprak të përgatitur nga ekspertja e emëruar nga Këshilli i Europës, Dr. Jannika Jahn.

### **III. Përcaktimi i kufijve për zbatimin e duhur të përgjegjësisë disiplinore gjyqësore**

10. Kompetencat e një gjyqtari lidhen me vlerat e së vërtetës, drejtësisë, ndershmërisë dhe lirisë.<sup>2</sup> Gjyqtarët duhet të kryejnë detyrat e tyre sipas standardit më të lartë të sjelljes profesionale në mënyrë që të përmbushin rolin e tyre kushtetues.<sup>3</sup> Pasoja e besimit të shoqërisë të gjyqësori me kompetenca kaq të gjera është që duhet të ekzistojnë disa mënyra që gjyqtarët të japin llogari, dhe madje edhe që të largohen nga detyra në raste të shkeljeve aq të rënda që justifikojnë këtë masë.<sup>4</sup> Kjo është veçanërisht e vërtetë në rastet e korrupsionit gjyqësor, të cilat minojnë në thelb besimin e publikut në paanshmërinë dhe pavarësinë gjyqësore.<sup>5</sup> Përgjegjësia disiplinore është një mjet për të siguruar që gjyqtarët t'u përmbahen detyrave të tyre. Në këtë mënyrë, kontribuohet në ruajtjen e besimit të publikut në administrimin e drejtësisë.
11. Të tre pushtetet janë përgjegjëse ndaj shoqërisë së cilës i shërbejnë. Përgjegjësia disiplinore e gjyqtarëve parashikon llogaridhënien e gjyqësorit. Megjithatë, kjo nuk do të thotë që gjyqësori është i varur nga një pushtet tjetër i shtetit. Kjo do të tradhtonte funksionin kushtetues të gjyqësorit si një pushtet i përbërë nga arbitra të pavarur, funksioni i të cilëve është të vendosin mbi çështjet në mënyrë të paanshme dhe sipas ligjit.<sup>6</sup> Kjo gjithashtu do të minonte vetë themelin e një shteti të qeverisur nga sundimi i ligjit që garanton të drejta dhe liri specifike për qytetarët e tij.<sup>7</sup>
12. Si një standard i përgjithshëm, KKGJE nënvizon se të drejtat individuale të gjyqtarëve dhe legjitimiteti i tyre funksional, i cili shërben si justifikim dhe kufizim i fuqisë së tyre duhet të përcaktojnë kufijtë e duhur për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve. Përgjegjësia disiplinore nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin legjitim të të drejtave individuale të gjyqtarëve, siç është liria e tyre e shprehjes, e përcaktuar në nenin 10 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), e drejta e tyre për jetë private sipas nenit 8 të KEDNJ-së ose e drejta e tyre për një gjykim të drejtë sipas nenit 6 të KEDNJ-së.<sup>8</sup> Për më tepër, arsyet për përgjegjësinë disiplinore gjyqësore duhet të jenë të lidhura në mënyrë të natyrshme me rolin kushtetues të gjyqësorit. Kjo përfshin nevojën për të siguruar që gjyqtarët të veprojnë si arbitra të pavarur dhe të paanshëm, duke respektuar sundimin e ligjit, dhe që ata në përgjithësi të kontribuojnë në funksionimin e duhur të administrimit të drejtësisë.

---

<sup>2</sup> KKGJE Opinion nr. 18 (2015), paragrafi 18.

<sup>3</sup> Në Opinionin e tij nr. 3 (2002), KKGJE diskutoi këto standarde dhe parime të sjelljes profesionale.

<sup>4</sup> KKGJE Opinion nr. 18 (2015), paragrafi 33.

<sup>5</sup> KKGJE Opinion nr. 18 (2015), paragrafi 33.

<sup>6</sup> KKGJE Opinion nr. 18 (2015), paragrafi 20.

<sup>7</sup> Cf. GJEDNJ, *Denisov kundër Ukrainës* [DHM], 25.9.2018, Nr. 76639/11, paragrafët 83 ff.; *Baka kundër Hungarisë*.

<sup>8</sup> Cf. GJEDNJ, *Denisov kundër Ukrainës* [DHM], 25.9.2018, Nr. 76639/11, paragrafët 83 ff.; *Baka kundër Hungarisë*.

13. Parimet thelbësore rrjedhin nga ky përcaktim i kufijve të përdorimit të duhur të përgjegjësisë disiplinore gjyqësore:
- a. përgjegjësia disiplinore është e nevojshme për të ruajtur besimin te gjyqësori;
  - b. përgjegjësia disiplinore nuk duhet të minojë pavarësinë e gjyqësorit;
  - c. përgjegjësia disiplinore është e rëndësishme për të siguruar administrimin e duhur të drejtësisë në përputhje me sundimin e ligjit;
  - d. objekti i përgjegjësisë disiplinore duhet të përcaktohet qartë në mënyrë që të jetë në përputhje me sundimin e ligjit;
  - e. institucionet procedurale të përfshira në procedimet disiplinore duhet të respektojnë ndarjen e pushteteve dhe administrimin e duhur të drejtësisë;
  - f. ushtrimi legjitim i të drejtave të ligjshme të një gjyqtari nuk duhet të shkaktojë përgjegjësi disiplinore;
  - g. çdo masë disiplinore e vendosur ndaj një gjyqtari duhet të jetë proporcionale.

#### **IV. Kuadri ligjor dhe organizimi i procedimit disiplinor kundër gjyqtarëve**

14. Përgjigjet e shteteve anëtare të KKGJE-së në pyetësor tregojnë se ekziston një kuadër ligjor për procedimet disiplinore kundër gjyqtarëve në pothuajse të gjitha shtetet. Në disa vende, dispozitat përkatëse janë të sanksionuara në kushtetutë; në shumicën e vendeve ato janë në ligj me ose pa dekrete, urdhëresa ose rregulla shtesë. Në disa shtete, por jo në të gjitha, gjyqtarët ose shoqatat e gjyqtarëve kanë marrë pjesë në hartimin e këtyre ligjeve.
15. Organizimi i procedimeve disiplinore ndryshon nga një vend në tjetrin. Në varësi të ngjashmërive dhe ndryshimeve të tyre, sistemet e organizimit disiplinor mund të ndahen gjerësisht në dy kategori: sistemi i këshillit dhe sistemi i gjykatës. Sistemi i këshillit i referohet një sistemi ku një Këshill për Gjyqësorin merr vendimin përfundimtar, ndërsa në sistemin e gjykatës është një tribunal i përgjithshëm ose disiplinor. Në sistemin e gjykatës, zakonisht është Ministria e Drejtësisë ose një prokuror i përgjithshëm që fillon procedimin disiplinor ndaj një gjyqtari para tribunalit disiplinor. Në sistemin e këshillit, grupi i personave dhe institucioneve që mund të fillojnë procedimin para këshillit gjyqësor është shumë më i gjerë. Ai varion nga Ministria e Drejtësisë deri te kryetarët e gjykatave, palët në proces, individët ose avokatët. Në të dy sistemet, ankesat ose informacioni në lidhje me shkeljen gjyqësore mund të paraqiten zyrtarisht ose jo pranë institucionit kompetent pa kufizime personale.
16. Në disa sisteme këshilli, ekziston procedura e ankimit brenda Këshillit Gjyqësor; në të tjera, ankimi shkon në një gjykatë më të lartë, madje edhe në gjykatën kushtetuese në rrethana të caktuara. Në disa vende, kryetarët e gjykatave kanë autoritetin të marrin një vendim disiplinor në rastet e paralajmërimeve ose vërejtjeve më të lehta. Në disa vende, procedimet disiplinore trajtohen nga një komision parlamentar për disiplinën gjyqësore, nga Kryetari i Gjykatës, përkatësisht Kryetari i Gjykatës së Apelit, ose nga Bordi Shtetëror Disiplinor për Nëpunësit e Lartë. Në disa raste të tjera, Avokati i Popullit dhe Kancelari i Drejtësisë mund të fillojnë procedimin disiplinor.
17. Në shumicën dërrmuese të vendeve, ka garanci për mbrojtjen e pavarësisë dhe paanshmërisë së institucioneve të përfshira në procedimet disiplinore, veçanërisht

organin vendimmarrës. Në disa vende, ofrohen garanci për të siguruar që të gjitha institucionet të jenë të pavarura pas fazës së inicimit, sidomos organi hetimor dhe organi vendimmarrës. Në vende të tjera, theksohen disa risqe për një formë të caktuar të politizimit të procedimit. I tillë është rasti kur prokurorët hetues janë në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, kur i njëjti person inicion dhe vendos për procedimin si anëtar i Këshillit Gjyqësor, ose kur anëtarët e Këshillit Gjyqësor emërohen nga Parlamenti. Ekziston po i njëjti risk nëse anëtarët e Këshillit Gjyqësor emërohen nga ekzekutivi.

18. KKGJE thekson rëndësinë e garancive të forta në nivel kushtetues ose legjislativ në lidhje me përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe zbatimin e këtyre garancive në praktikë.<sup>9</sup> Ai thekson se pavarësia e gjyqtarëve duhet të mbrohet siç duhet nga praktikat arbitrare dhe të papërshtatshme disiplinore që ushtrohen kundër gjyqtarëve. Dispozitat materiale dhe procedurale duhet të përcaktohen me ligj. Në procesin e përgatitjes së ligjeve disiplinore për gjyqtarët, është thelbësore që të ketë konsultime domethënëse me gjyqtarët, sidomos me shoqatat e tyre<sup>10</sup>, të cilave duhet t'u jepet mundësia të vlerësojnë dhe të komentojnë për legjislacionin e synuar në çështjet që lidhen me statusin e gjyqtarëve.<sup>11</sup>
19. Organi që është përgjegjës për fillimin e një procedimi disiplinor dhe hetimin e tij nuk duhet të jetë i njëjti organ që vendos për çështjen disiplinore. Pasi një anëtar i publikut të ketë bërë ankesën, ky person nuk duhet të marrë pjesë në procedimin disiplinor vijues.<sup>12</sup> KKGJE rekomandon që shtetet anëtare të kenë një organ ose person specifik hetimor përgjegjës për të marrë ankesat, për të marrë parashtrimet e gjyqtarit dhe për të vlerësuar nëse ka apo jo një rast të mjaftueshëm kundër gjyqtarit për të kërkuar fillimin e procedimit. Organi hetimor nuk duhet të ndikohet politikisht. Në disa sisteme ligjore ku administrimi i drejtësisë është nën autoritetin e Ministrisë së Drejtësisë, mund të paraqitet një rrezik real në këtë drejtim nëse prokurorët disiplinorë emërohen nga qeveria ose autoritetet e lidhura me qeverinë<sup>13</sup> dhe nëse ata janë sistematikisht në varësi të ekzekutivit përgjegjës për administrimin e drejtësisë.
20. Gjyqtarët që përballen me një akuzë disiplinore duhet të kenë të drejtën për t'ju drejtuar një gjykate ose autoriteti të pavarur të krijuar me ligj në përputhje me nenin 6 të KEDNJ-së.<sup>14</sup> Është shumë e rëndësishme që çdo ndikim i ekzekutivit ose parlamentit mbi organin vendimmarrës të përjashtohet në këto procedime disiplinore.<sup>15</sup> Kur organi disiplinor vendimmarrës nuk është vetë gjykata, atëherë anëtarët e tij duhet të plotësojnë kërkesat e përgjithshme të pavarësisë dhe paanshmërisë. Kriteret përkatëse përfshijnë emërimin

<sup>9</sup> Vlerësimi i CDCJ-së për Zbatimin e Planit të Veprimit të Këshillit të Europës për Forcimin e Pavarësisë dhe Paanshmërisë Gjyqësore, paragrafët 223-224; shihni gjithashtu, në përgjithësi Opinionin nr. 1 (2001) të KKGJE-së dhe Opinionin nr. 6 (2004).

<sup>10</sup> KKGJE Opinion nr. 18 (2015), paragrafi 31.

<sup>11</sup> KKGJE Opinion nr. 23 (2020), Kreu IX, klauzola 7.

<sup>12</sup> Kjo nuk vlen për sistemet e ankesave në disa shtete anëtare ku, për shembull, një qytetar mund të paraqesë një ankesë në lidhje me sjelljen e një gjyqtari, me kusht që sipas sistemit: (1) ankesa të mos ketë të bëjë me vendimet e marra nga gjyqtari në një çështje, (2) ankesat e pabazuara të rrëzohen në mënyrë efektive dhe të shpejtë, dhe (3) të drejtat e gjyqtarit të mbrohen siç duhet. Për ankesat e pabazuara, shihni më tej paragrafin 32.

<sup>13</sup> Në disa shtete anëtare, edhe kryetari i gjykatës mund të ketë një lidhje me ekzekutivin.

<sup>14</sup> Cf. GJEDNJ *Pajak kundër Polonisë*, 24.10.2023, nr. 25226/18, 25805/18, 8378/19, 43949/19, paragrafët 167-200, esp. 194-195; GJEDNJ *Baka kundër Hungarisë* [DHM], nr 20261/12, 23.6.2016, paragrafët 100-106; cf. *Vilho Eskelinen dhe të tjerë kundër Finlandës*, 19.4.2007, nr. 63235/00, paragrafi 62; cf. Rekomandim CM/Rec(2010) 12, paragrafi 69.

<sup>15</sup> Cf. GJEDNJ *Reczkowicz kundër Polonisë*, 22.7.2021, nr. 43447/19; GJEDNJ *Tuleya kundër Polonisë*, 6.7.2023, nr. 21181/19, 51751/20, paragrafi 340; GJEDNJ *Miroslava Todorova kundër Bullgarisë*, 19.10.2021, nr. 40072/13. Cf. Raporti Ad hoc i GRECO-s për Poloninë (Rregulli 34), paragrafi 59 (iv); Raundi i Katërt i Vlerësimit të GRECO-s: parandalimi i korrupsionit në lidhje me anëtarët e parlamentit, gjyqtarët dhe prokurorët, Raporti i Ndërmjetëm i Pajtueshmërisë për Poloninë 2021, paragrafi 73.

e duhur, një mandat të caktuar, sigurinë e qëndrimit në detyrë, një garanci kundër ndërhyrjes, dukjen e pavarësisë dhe mundësinë e përjashtimit në rast paragjykimi dhe një përfaqësim të konsiderueshëm të gjyqtarëve brenda këtij organi.<sup>16</sup> Këshillat Gjyqësore, nëse ekzistojnë, janë në pozitën më të mirë në këtë drejtim.<sup>17</sup>

21. Sa i përket procedurës së emërimit, KKGJE konfirmon qëndrimin e tij që anëtarët e organeve disiplinore që nuk janë gjykata duhet të emërohen nga një autoritet i pavarur që përbëhet kryesisht nga gjyqtarë të emëruar nga gjyqtarë të tjerë.<sup>18</sup>
22. Lidhur me përbërjen e organit vendimmarrës, KKGJE rekomandon që Ministri i Drejtësisë dhe/ose anëtarë të tjerë të ekzekutivit të mos jenë anëtarë të Këshillit Gjyqësor, kur ai vepron si organ disiplinor, veçanërisht nëse ai ose ajo është gjithashtu i autorizuar të fillojë procedimin kundër një gjyqtari.<sup>19</sup> Kjo jo vetëm që do të përbënte problem për pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit, por edhe për parimin kushtetues të ndarjes së pushteteve. Anëtarët e organit disiplinor duhet të përjashtohen nga hetimi paraprak në një çështje disiplinore, sepse një dyfishim i tillë i funksioneve mund të hedhë dyshime objektive mbi paanshmërinë e këtyre anëtarëve.<sup>20</sup> Përfaqësuesit e prokurorisë, pra prokurori i përgjithshëm dhe ata që janë deleguar nga autoriteti i prokurorisë, të cilët janë përgjegjës në fazën hetimore të procedimeve disiplinore, nuk duhet të përfshihen në përbërjen e organit disiplinor për gjyqtarët. Kjo do të bashkonte funksionin hetimor dhe akuzator nga njëra anë dhe funksionin gjyqësor nga ana tjetër.<sup>21</sup>
23. Duhet të ekzistojë një organ/tribunal rishikimi me kompetencë të plotë<sup>22</sup> për të dëgjuar ankimet, d.m.th., ai mund të rishikojë si procedurën ashtu edhe themelin e vendimit dhe duhet të jetë i pavarur dhe i paanshëm. Organi i rishikimit duhet të ketë kompetencë për të rrëzuar vendimet disiplinore dhe për të ndërmarrë çdo hap të mëtijshëm korrigjues sipas nevojës. Nuk mjafton që organi i rishikimit vetëm të shpallë vendimin e mëparshëm të paligjshëm.<sup>23</sup> Është thelbësore që organi i rishikimit të përjashtojë anëtarët që ishin gjithashtu anëtarë të organit që ndërmori procedimin disiplinor fillestar.<sup>24</sup>
24. Në shtetet anëtare ku ka anëtarë jo profesionistë, shumica e anëtarësisë duhet të jenë anëtarë të gjyqësorit.

## V. Shkaqet për përgjegjësinë disiplinore

25. Në shumicën e shteteve anëtare të KKGJE-së, shkaqet për përgjegjësi disiplinore janë të përcaktuara me ligj dhe mbulojnë shkelje gjyqësore dhe jashtëgjyqësore. Përmbajtja dhe formulimi mund të ndryshojnë. Për shkak të diversitetit kulturor, i cili ndikon në pritshmëritë e publikut për sjelljen e gjyqtarëve, shkaqet për përgjegjësi disiplinore

<sup>16</sup> Cf. GJEDNJ, *Denisov kundër Ukrainës* [DHM], 25.9.2018, nr. 76639/11, paragrafët 60-65.

<sup>17</sup> Raport i Komisionit të Venecias për pavarësinë e Sistemit Gjyqësor. Pjesa I: Pavarësia e Gjyqtarëve miratuar nga Komisioni i Venecias në Seancën Plenare të 82<sup>të</sup> (Venecia, 12-13 mars 2010), paragrafi 43.

<sup>18</sup> Cf. Opinion i KKGJE Nr. 3 (2002), paragrafi 77; cf. GJEDNJ *Denisov kundër Ukrainës* [DHM], 25.9.2018, nr. 76639/11, paragrafët 68-72; GJEDNJ, *Volkov kundër Ukrainës*, 9.1.2013, nr. 21722/11, paragrafi 112.

<sup>19</sup> Cf. *Pajak kundër Polonisë*, 24.10.2023, nr. 25226/18, 25805/18, 8378/19, 43949/19.

<sup>20</sup> Cf. GJEDNJ *Denisov kundër Ukrainës* [DHM], 25.9.2018, No. 76639/11, paragrafët 68-72; GJEDNJ *Volkov kundër Ukrainës*, 9.1.2013, nr. 21722/11, paragrafi 115. Komisioni i Venecias CDL-AD(2015)042, para 73.

<sup>21</sup> Cf. GJEDNJ *Denisov kundër Ukrainës* [DHM], 25.9.2018, No. 76639/11, paragrafët 68-72; GJEDNJ *Volkov kundër Ukrainës*, 9.1.2013, nr. 21722/11, paragrafi 114.

<sup>22</sup> Ky Opinion i referohet formulimit të GJEDNJ-së në çështjen *Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë* [DHM], 6.11.2018, 55391/13 57728/13 74041/13, paragrafët 176 et seq.

<sup>23</sup> GJEDNJ *Denisov kundër Ukrainës* [DHM], 25.9.2018, nr. 76639/11, paragrafi 74; GJEDNJ *Volkov kundër Ukrainës*, 9.1.2013, nr. 21722/11, paragrafi 124 -129.

<sup>24</sup> GJEDNJ, *Kozan kundër Turqisë* 1.3.2022, nr. 16695/19, paragrafi 79.

ndryshojnë, veçanërisht në lidhje me sjelljen private të gjyqtarëve. Ndonëse gjyqtarët mund të shprehin mendime politikisht kontradiktore në mediat sociale në një vend, ata nuk mund ta bëjnë këtë në një vend tjetër. Në disa vende, shkaqet për përgjegjësi gjyqësore renditen në një listë shteruese të formuluar në mënyrë strikte, në vende të tjera ato janë të përfshira në formulime që janë më të hapura.

26. Gjyqtarët kanë të drejtën e lirisë së shprehjes sipas nenit 10 të KEDNJ-së, siç specifikohet më tej në Opinionin nr. 25 (2022). Ushtrimi legjitim nga gjyqtarët i të drejtave të tyre sipas nenit 10 të KEDNJ-së nuk duhet të shkaktojë përgjegjësi disiplinore.<sup>25</sup> E drejta e lirisë së shprehjes përfshin të drejtën e gjyqtarëve për të folur publikisht për procedimet disiplinore ndaj tyre ose kolegëve të tyre. Shkaqet për përgjegjësi disiplinore nuk duhet të cenojnë të drejtën e gjyqtarit për jetë private dhe familjare në përputhje me nenin 8 të KEDNJ-së.
27. Në çdo shtet anëtar, ligji duhet të përcaktojë shprehimisht<sup>26</sup> dhe, sa të jetë e mundur, në terma specifikë<sup>27</sup>, shkaqet për të cilat mund të iniciohen procedimet disiplinore ndaj gjyqtarëve. Duhet të përjashtohet mundësia e prezantimit të shkaqeve *ad hoc* që zbatohen në mënyrë retroaktive. Dispozitat e paqarta (si "shkelja e betimit" ose "sjellja joetike") japin mundësi për interpretim tepër të gjerë dhe abuzim, që mund të jenë të rrezikshëm për pavarësinë e gjyqtarëve.<sup>28</sup> Publikimi i rregullt i vendimeve disiplinore mund të ndihmojë në sqarimin e mëtejshëm të dispozitave ligjore.<sup>29</sup>
28. Vendimi i një gjyqtari, sidomos interpretimi i ligjit, vlerësimi i fakteve ose peshimi i provave dhe/ose shmangia nga praktika e konsoliduar gjyqësore nuk duhet të shkaktojë përgjegjësi disiplinore, përveç rasteve të keqdashjes, mospërmbyshjes me dashje të detyrës ose shkeljes së rëndë.<sup>30</sup> Po kështu, paraqitja e një procedure paraprake referimi në përputhje me nenin 267 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Europian (TFBE) ose kërkesa për një Opinion Këshillimor të GJEDNJ-së nuk duhet të shkaktojë përgjegjësi gjyqësore. Çdo akt që ndikon në mundësinë e përdorimit të interpretimit të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian (GJDBE) përbën një sulm serioz ndaj sundimit të ligjit. Shkaqet për përgjegjësinë disiplinore duhet t'i referohen sjelljes gjyqësore që bie ndesh me një nga vlerat themelore të sanksionuara në Konventë: pavarësia, paanshmëria, korrektësia, integriteti, barazia, mosdiskriminimi, kompetenca dhe kujdesi.<sup>31</sup> KKGJE paralajmëron kundër justifikimit të shkaqeve për përgjegjësi disiplinore të gjyqtarëve duke iu referuar reputacionit të gjyqësorit, përveçse kur synohet t'i referohet autoritetit dhe besimit të publikut te gjyqësori.
29. KKGJE thekson rëndësinë e një kriteri në limit për të dalluar shkeljen që mund të justifikojë vendosjen e masave disiplinore nga format e tjera të sjelljes së gabuar.
30. Standardet etike duhet të dallohen qartë nga shkelja që justifikon masat disiplinore. Meqenëse qëllimi i një kodi etike është i ndryshëm nga ai i arritur përmes një procedimi disiplinor, kodi etik nuk duhet të përdoret si mjet për disiplinimin e gjyqtarëve. Kur standardet etike dhe rregullat profesionale të sjelljes ndërthuren në lidhje me sjelljen jashtëgjyqësore që potencialisht çënon besimin e publikut te gjyqësori, kriteri në limit

<sup>25</sup> KKGJE Opinion Nr. 25 (2022), paragrafi 35 dhe Rekomandime.

<sup>26</sup> Komisioni i Venecias CDL-AD(2016)009, paragrafi 34.

<sup>27</sup> KKGJE Opinion nr. 3 (2002), paragrafi 77.

<sup>28</sup> Komisioni i Venecias CDL-AD(2016)013, paragrafët 24-27; CDL-AD(2018)032, paragrafi 78.

<sup>29</sup> Komisioni i Venecias CDL-AD(2016)013, paragrafi 27.

<sup>30</sup> Rekomandim CM/Rec(2010)12, paragrafi 66; Opinion i KKGJE nr. 3 (2002), paragrafi 60. Çështjet shëndetësore ose rrethana të tjera të veçanta duhet të merren parasysh kur specifikohet keqdashja, mospërmbyshja me dashje e detyrës dhe shkelja e rëndë.

<sup>31</sup> Shihni Parimet e Bangalore për Sjelljen Gjyqësore (2002); KKGJE Opinioni nr. 21 (2018). Duhet theksuar se çdo çështje sistematike e mbartur nuk duhet të interpretohet si e tillë që përbën shkelje të rëndë të një gjyqtari.

ndihmon për të bërë dallimin ndërmjet sjelljes joetike dhe sjelljes që duhet t'i nënshtrohet përgjegjësisë disiplinore.

## **VI. Garancitë procedurale në procedimet disiplinore kundër gjyqtarëve**

31. Procedura mund të ndahet përafërsisht në katër faza: faza e informacionit/ankesës, faza e hetimit, faza e raportimit/fillimit dhe faza e vendimit. Në shumicën e vendeve, gjyqtarët informohen në fazën e parë ose të dytë të procedimit. Vetëm disa vende kanë një mekanizëm formal ankimi. Pjesa tjetër e procedurave është e rregulluar formalisht në shumicën e shteteve anëtare. Duke pasur parasysh organizimin e larmishëm të procedimeve, organe të ndryshme janë të përfshira në katër fazat e procedimeve. Në disa vende, një Panel Hetimor i thirrur nga Këshilli Gjyqësor drejton fazën e hetimit e cila përfundon me një raport që përbën bazën për vendimin mbi ankimin disiplinor nga Këshilli Gjyqësor. Në vende të tjera, hetimet nga prokuroria përfundojnë me një akuzë specifike, për të cilën vendoset në gjykatë. Ndonëse në disa vende procedimet disiplinore ndjekin procedurën civile, në vende të tjera ato ndjekin procedurën penale ose administrative. Vetëm në disa vende çështjet disiplinore vendosen pas një seance dëgjimore publike. Në shumë vende ku vendimet përfundimtare bëhen publike, ato anonimizohen.
32. Është thelbësore të shmanget çdo abuzim me procedimet disiplinore. Prandaj, fillimi i procedimit disiplinor duhet të mbështetet në shkaqe të vlefshme ligjore. Shkaqet duhet të përmbushin kriteret e ligjshmërisë, d.m.th. ato duhet të jenë të përcaktuara qartë, të sakta dhe të parashikueshme në zbatimin e tyre, në mënyrë që t'i lejojnë një gjyqtari të parashikojë në masë të arsyeshme pasojat disiplinore që mund të sjellë një veprim i caktuar.<sup>32</sup> Ankesat e pabazuara ose ato që lidhen vetëm me vendimin ose sjelljen e një gjyqtari në proceset para tij (d.m.th. gabim në gjykim, procedurë, ligj material) duhet të refuzohen si të papranueshme dhe të rrëzohen menjëherë. Shtetet anëtare duhet të jenë të vetëdijshme se lejimi i ankesave si mënyrë për të filluar procedimin disiplinor mund të çojë në një akumulim të ankesave me efekte të dëmshme në zgjidhjen në kohë të ankesave.<sup>33</sup> Në këto raste, KKGJE këshillon shtetet anëtare të parashikojnë një sistem filtrimi për trajtimin e ankesave.
33. KKGJE rekomandon për kufizime të qarta kohore në lidhje me procedimet disiplinore. Lidhur me detyrën gjyqësore, kjo siguri ligjore mbështet pavarësinë e një gjyqtari.
34. KKGJE thekson se të gjitha garancitë e përgjithshme procedurale të përcaktuara në nenin 6 të KEDNJ-së zbatohen për procedimet disiplinore kundër gjyqtarëve.<sup>34</sup> Shtetet anëtare duhet të përcaktojnë rregulla të qarta procedurale në ligj që zbatohen për procedimet disiplinore kundër gjyqtarëve.
35. KKGJE thekson se gjyqtarët duhet të kenë mundësi të marrin pjesë në mënyrë efektive në procedimet disiplinore kundër tyre. Gjyqtarët kanë të drejtë të informohen dhe të dëgjohen, si dhe të mbrojnë veten. KKGJE u bën thirrje shteteve anëtare të sigurojnë që të vendoset barazia e armëve në proceset kundërshtare. Për këtë qëllim, një gjyqtar

<sup>32</sup> GJEDNJ *Khlaifia dhe të tjerë kundër Italisë* [DHM], 15.12.2016, 16483/12, paragrafi 92; *J.N. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 19.5.2016, 37289/12, paragrafi 77; *Del Río Prada kundër Spanjës* [DHM], 21.10.2013, 42750/09, paragrafi 125; *Medvedyev dhe të tjerë kundër Francës* [DHM], 29.3.2010, 3394/03, paragrafi 80.

<sup>33</sup> Cf. Standardet Minimale Gjyqësore V Procedimet disiplinore dhe përgjegjësia e gjyqtarëve ENCJ Raport 2014- 2015, fq. 25.

<sup>34</sup> Cf. GJEDNJ *Baka kundër Hungarisë* [DHM], 23.6.2016, nr. 20261/12, paragrafët 100-106; cf. *Vilho Eskelinen dhe të tjerë*, cituar më lart, § 62.

duhet të ketë të drejtën e përfaqësimit ligjor. Nëse dëshmia e dëshmitarëve lejohet në seancën dëgjimore, dëshmitarët e të dyja palëve duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë.<sup>35</sup> Për më tepër, një gjyqtar mund të japë llogari për shkelje disiplinore vetëm nëse provohet shkelja.

36. Karakteri publik i procedimit para organeve gjyqësore i mbron palët në gjyq kundër administrimit të drejtësisë në fshehtësi në mungesë të shqyrtimit publik.<sup>36</sup> Prandaj, KKGJE nënvizon se ndonëse hetimet duhet të jenë konfidenciale, seanca dëgjimore duhet të mbahet e hapur, përveçse kur ka arsye të përcaktuara në nenin 6 të KEDNJ-së për një seancë me dyer të mbyllura.<sup>37</sup> Vendimet disiplinore duhet të jenë të arsyetuara siç duhet, d.m.th. të adresojnë të gjitha aspektet përkatëse të paraqitura nga organi hetues dhe gjyqtari.<sup>38</sup> Ato duhet të shpallen dhe të publikohen. Emrat, kur publikohen, mund të anonimizohen. Vendimet duhet të plotësohen gjithashtu me statistika mbi vendimet disiplinore.<sup>39</sup> Bërja publike e procedimeve dhe vendimeve është e rëndësishme për transparencën e procedimeve disiplinore dhe për forcimin e besimit të publikut në administrimin e duhur të drejtësisë.
37. Shtetet anëtare duhet të zhvillojnë procedimet brenda një afati kohor të arsyeshëm. Kjo do të thotë që drejtësia duhet të administrohet pa vonesa, pasi këto mund të rrezikojnë efektivitetin dhe besueshmërinë e saj.<sup>40</sup> Afati i arsyeshëm varet nga kompleksiteti i çështjes dhe të gjitha rrethanat përkatëse, si dhe nga rëndësia e çështjes për ankuesin.<sup>41</sup> Procedimet disiplinore të iniciuara kundër një gjyqtari mund të rezultojnë me një konkluzion në kohë. Në rast vonese të tepërt, gjyqtarit duhet t'i vihet në dispozicion një procedurë për të paraqitur kërkesë për pushimin e procedimit.
38. KKGJE përsërit qëndrimin e saj që gjyqtarëve duhet t'u jepet e drejta për të apeluar kundër vendimeve dhe masave disiplinore.<sup>42</sup>

## VII. Masat disiplinore kundër gjyqtarëve

39. Në shumicën e shteteve ekziston një listë shteruese e masave të mundshme disiplinore për gjyqtarët. Megjithatë, mbetet një farë hapësire interpretimi për zbatimin e masave rast pas rasti. Në të gjitha shtetet, parimi i proporcionalitetit zbatohet për vendosjen e masës së përshtatshme. Masat mund të përfshijnë një paralajmërim, vërejtje, gjobë të përshtatshme, ricaktim, pezullim nga detyra, pension të parakohshëm (të detyrueshëm) dhe shkarkim.
40. KKGJE përsërit që masat disiplinore duhet të përcaktohen qartë në ligj, të jenë lehtësisht të aksesueshme dhe të renditura në një listë shteruese.<sup>43</sup> Parimi i proporcionalitetit duhet të udhëheqë vendimin.<sup>44</sup> Ai kërkon një ushtrim balancimi ndërmjet rëndesës së veprës

<sup>35</sup> GJEDNJ *Ankerl kundër Zvicrës*, 23.10.1996, nr. 17748/91, paragrafi 38; përndryshe shihni *Dombo Beheer B.V. kundër Holandës*, 27.10.1993, nr. 14448/88, paragrafi 35.

<sup>36</sup> GJEDNJ *Fazliyski kundër Bullgarisë*, 1.6.2010, nr. 40908/05, paragrafi 69.

<sup>37</sup> GJEDNJ *Ramos Nunes de Carvalho e sá kundër Portugalisë* [DHM], 6.11.2018, Nr. 55391/13 57728/13 74041/13, paragrafi 208.

<sup>38</sup> Cf. *Simić kundër Bosnjë-Hercegovinës* (dec.), 15.11.2016, nr. 75255/10, paragrafët 35-36.

<sup>39</sup> Cf. KKGJE Opinion nr. 3 (2002), paragrafët 15, 23.

<sup>40</sup> GJEDNJ *Scordino kundër Italisë* (nr. 1) [DHM], 29.3.2006, nr. 36813/97, paragrafi 224.

<sup>41</sup> GJEDNJ *Comingersoll S.A. kundër Portugalisë* [DHM], 6.4.2000, nr. 35382/97; GJEDNJ *Frydlender kundër Francës* [DHM], 27.6.2000, nr. 30979/96, paragrafi 43; GJEDNJ *Sürmeli kundër Gjermanisë* [DHM], 8.6.2006, nr. 75529/01, paragrafi 128.

<sup>42</sup> Rekomandim CM/Rec(2010)12, paragrafi 69; cf. Raundi i Katërt i Vlerësimit i GRECO-s: parandalimi i korrupsionit në lidhje me deputetët, gjyqtarët dhe prokurorët: konkluzione dhe tendenca (2017), faqe. 18.

<sup>43</sup> KKGJE Opinion nr. 3 (2002), paragrafi 77; cf. në lidhje me zbatimin e parimit të proporcionalitetit, Rekomandim CM/Rec(2010)12, paragrafi 69; Komisioni i Venecias CDL-AD(2014)039, paragrafi 72.

<sup>44</sup> Ibid.

penale dhe pasojave të saj nga njëra anë, dhe cilësisë dhe shumës së masës nga ana tjetër.<sup>45</sup> Shkarkimi i një gjyqtari duhet të urdhërohet vetëm si mjet i fundit në raste jashtëzakonisht të rënda.<sup>46</sup> Një transferim dhe/ose ri-caktim (edhe i përkohshëm) i një gjyqtari, ose një ulje në detyrë mund të justifikohet vetëm në rastet e shkeljes së rëndë gjyqësore.<sup>47</sup> KKGJE është kundër uljes së pagës si masë disiplinore sepse gjyqtarët duhet të shpërblehen në mënyrë të barabartë për punë të ngjashme.

41. Të gjithë faktorët lehtësues dhe rëndues të rastit individual duhet të merren parasysh në mënyrë që të përcaktohet qartë përgjegjësia e gjyqtarit nisur nga rrethanat specifike ku është kryer shkelja disiplinore.
42. Në të gjitha rastet, "efekti i mundshëm frenues" që mund të ketë një masë ndaj gjyqtarit individual dhe gjyqtarëve të tjerë duhet të merret parasysh kur vlerësohet masa e përshtatshme.<sup>48</sup>
43. KKGJE thekson se disa masa që synojnë ose mund të kenë të njëjtin efekt si masat disiplinore duhet të trajtohen si të tilla me të gjitha të drejtat gjyqësore dhe garancitë procedurale që zbatohen.<sup>49</sup> Kjo vlen edhe për çdo masë, pavarësisht formës së saj, e cila ka për synim të ndëshkojë një gjyqtar.

## VIII. Rekomandime

1. Gjyqtarët duhet të kryejnë detyrat e tyre sipas standardeve më të larta të sjelljes profesionale në mënyrë që të përmbushin rolin e tyre kushtetues. Përgjegjësia disiplinore është një mjet për të siguruar që gjyqtarët t'i përmbahen standardeve të tyre të sjelljes profesionale.
2. Përgjegjësia disiplinore nuk duhet të minojë pavarësinë e gjyqësorit.
3. Përgjegjësia disiplinore e gjyqtarëve konsiderohet e rëndësishme për të siguruar administrimin e duhur të drejtësisë në përputhje me sundimin e ligjit dhe e nevojshme për të ruajtur besimin te gjyqësori.
4. Shtetet Anëtare duhet të kenë garanci të forta në nivel kushtetues ose ligjor në lidhje me përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe t'i zbatojnë këto garanci në praktikë.
5. Institucionet procedurale të përfshira në procedimet disiplinore duhet të respektojnë ndarjen e pushteteve dhe administrimin e duhur të drejtësisë. Gjyqtarët dhe shoqatat e tyre duhet të konsultohen për legjislacionin dhe rregullat e disiplinës.

<sup>45</sup> Komisioni i Venecias CDL-AD(2014)039, paragrafi 72.

<sup>46</sup> Cf. Komisioni i Venecias CDL-AD(2015)042, paragrafi 113; Raundi i Katërt i Vlerësimit i GRECO-s: parandalimi i korrupsionit në lidhje me deputetët, gjyqtarët dhe prokurorët: konkluzione dhe tendenca (2017), faqe. 18.

<sup>47</sup> Cf. CEPEJ Raporti Vlerësimit të Sistemeve Gjyqësore Europiane, 2022 Cikli i Vlerësimit (të dhëna 2020), fq 50. Palëvizshmëria e gjyqtarit nuk do të thotë që gjyqtarit nuk mund t'i caktohet një detyrë tjetër. Palëvizshmëria është një element kyç për ruajtjen e pavarësisë gjyqësore, GJEDNJ, *Baka kundër Hungarisë* [DHM], 23.6.2016, nr. 20261/12, paragrafi 172; Opinioni nr. 1 (2001) paragrafët 57-59.

<sup>48</sup> Cf. GJEDNJ *Baka kundër Hungarisë* [DHM], 23.6.2016, nr. 20261/12, paragrafi 173; *Žurek kundër Polonisë*, 16.6.2022, 39650/18, paragrafi 227; *Kozan kundër Turqisë*, 1.3.2022, nr. 16695/19, paragrafi 68; *Sarisu Pehlivan kundër Turqisë*, 6.6.2023, nr. 63029/19, paragrafi 48.

<sup>49</sup> I tillë është rasti për shembull kur ulet mosha e daljes në pension të gjyqtarëve dhe Ministria e Drejtësisë ose organi nën kontrollin politik të saj autorizohet që të vendosë nëse mandati i një gjyqtari, për të cilin fillimisht është vendosur një moshë daljeje në pension më e madhe, "shtyhet" sipas ligjit të ri deri në fund të mandatit fillestar. Shihni GJEDNJ *Pajak kundër Polonisë*, 24.10.2023, nr. 25226/18, 25805/18, 8378/19, 43949/19, paragrafët 167-200.

6. Organi që është përgjegjës për fillimin e një procedimi disiplinor dhe hetimin nuk duhet të jetë i njëjti organ që vendos për çështjen disiplinore. Shtetet anëtare duhet të kenë një organ ose person specifik hetimor përgjegjës për marrjen e ankimeve, për marrjen e parashtrimeve të gjyqtarit dhe për të vlerësuar nëse ka çështje të mjaftueshme kundër një gjyqtari për të kërkuar fillimin e këtij procedimi.
7. Gjyqtarët që përballen me një akuzë disiplinore duhet të kenë të drejtën për t'ju drejtuar një tribunali ose autoriteti të pavarur të krijuar me ligj në përputhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
8. Duhet të ekzistojë një organ/tribunal i pavarur vlerësimi që të ketë kompetencë të prishë vendimet disiplinore dhe të marrë çdo masë tjetër për të korrigjuar pasojat negative të këtyre vendimeve, siç janë rikthimet e menjëhershme.
9. Objekti i përgjegjësisë disiplinore duhet të përcaktohet qartë në mënyrë që të jetë në përputhje me sundimin e ligjit. Ligji duhet të përcaktojë shprehimisht dhe, sa të jetë e mundur, në terma specifikë, shkaqet për të cilat mund të iniciohen procedimet disiplinore ndaj gjyqtarëve.
10. Ushtrimi legjitim i të drejtave të ligjshme të një gjyqtari nuk duhet të shkaktojë përgjegjësi disiplinore.
11. Arsyet për përgjegjësi disiplinore gjyqësore duhet të lidhen me rolin kushtetues gjyqësor. Kjo përfshin nevojën për të siguruar që gjyqtarët të veprojnë si arbitra të pavarur dhe të paanshëm, duke respektuar sundimin e ligjit, dhe që ata në përgjithësi të kontribuojnë në funksionimin e duhur të administrimit të drejtësisë.
12. Vendimi i një gjyqtari, përfshirë interpretimin e ligjit, vlerësimet e fakteve ose provave nuk duhet të shkaktojë përgjegjësi disiplinore, përveçse në rast të keqdashjes, moskryerjes së detyrave me dashje ose shkeljes së rëndë. Paraqitja e një procedure paraprake referimi sipas nenit 267 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian (TFBE) dhe kërkesa për Opinion Këshillimor në GJEDNJ nuk duhet të çojë asnjëherë në përgjegjësi gjyqësore.
13. Duhet të vendoset një kriter në limit për të dalluar shkeljen që mund të justifikojë vendosjen e masave disiplinore nga format e tjera të sjelljes së gabuar.
14. Standardet etike duhet të dallohen qartë nga shkelja që justifikon masat disiplinore.
15. Shtetet anëtare duhet të parashikojnë rregulla të qarta procedurale në legjislacion që zbatohen për procedimet disiplinore kundër gjyqtarëve. Një sistem filtrimi duhet të parashikohet për trajtimin e ankesave, që të sigurohet rrëzimi i shpejtë i ankesave të pabazuara.
16. Në rast vonese të tepërt, gjyqtarit duhet t'i vihet në dispozicion procedura për të paraqitur kërkesë për pushimin e procedimit.
17. Gjyqtarët duhet të kenë mundësi të marrin pjesë në mënyrë efektive në procedimin disiplinor kundër tyre dhe të kenë përfaqësim ligjor.
18. Ata duhet të kenë të drejtën e ankimit kundër vendimeve dhe masave disiplinore.
19. Masat disiplinore duhet të përcaktohen qartë në legjislacion, të jenë lehtësisht të aksesueshme dhe të vendosen në një listë shteruese.

20. Çdo masë disiplinore e vendosur ndaj një gjyqtari duhet të jetë proporcionale.
21. Shkarkimi i një gjyqtari duhet të urdhërohet vetëm si mjet i fundit në raste tepër të rënda.
22. Në të gjitha rastet, "efekti i mundshëm frenues" që mund të ketë një masë ndaj gjyqtarit individual dhe gjyqtarëve të tjerë duhet të merret parasysh kur vlerësohet masa e përshtatshme.
23. Vetingu nuk duhet të përdoret si zëvendësim për masat disiplinore. Vetingu nuk mund të përdoret as për të adresuar korrupsionin.